



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më 13.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florion Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela, Lefter Koka.

Të ftuar:

Albana Shtylla – Zëvendësministre e Financave

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Rudina Bollano – Drejtore Ekzaminimi pranë DPPI-së

Lindita Mëneri – Përgjegjëse e Sektorit të Markave pranë DPPI-së

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi!

Para se të fillojmë me rendin e ditës, a jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Dakord.

Sot në rend të ditës kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”. Jemi komision përgjegjës.

Relatore e këtij projektligji është zonja Tatiana Nurçe Piro. Të ftuar në komision janë: Zëvendësministrja e Financave, znj. Albana Shtylla, z. Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, znj. Rudina Bollano, Drejtore Ekzaminimi pranë DPPI-së, dhe znj. Lindita Mëneri, Përgjegjëse e Sektorit të Markave.

Ju urojmë mirëseardhjen në komision!

Fjalën e ka relatorja, zonja Nurçe.

Tatiana Nurçe – Projektligji synon aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës, i cili mundëson regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës dhe lejon hyrjen në marrëveshjen e Lisbonës të organizatave ndërqeveritare. Aderimi në këtë akt do të ishte në interesin e mbajtësve të të drejtave mbi emërtimet e origjinës, të cilët me anë të një aplikimi të vetëm shkurtojnë kohë dhe kosto për mbrojtje në vendet e tjera.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë regjistruar deri tani 11 tregues gjeografikë dhe/ose emërtime origjine, me prejardhje nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, të tillë si keci i Hasit, boronica e bjeshkëve kuksiane dhe të Tropojës, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Malësisë së Madhe, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Tropojës, jufka dibrane, molla dibrane, etj. Regjistrimi kombëtar e më tej ai ndërkombëtar i këtyre produkteve ndikon në rritjen e vlerës së tyre, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore e gastronomike, si dhe ofron mundësinë e njohjes në tregjet e huaja të produkteve karakteristike shqiptare.

Aderimi në këtë akt sjell disa përfitime. Akti Gjenevës bën shumë ndryshime dhe përmirësime në modernizimin e sistemit të regjistrimit të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës. Siguron të drejta që kombinojnë elementet e mbrojtjes së markave të mirënjohura

dhe mbrojtjes së treguesve gjeografikë. Siguron mjete ligjore për vendet anëtare për të parandaluar një përdorim të paautorizuar të treguesve gjeografikë në tri situata, që janë: Mallrat që janë të njëjta me ato për të cilat është aplikuar për tregues gjeografikë; Shmang ndonjë praktikë që mashtron konsumatorët në lidhje me origjinën e vërtetë apo natyrën e mallrave, përfshirë imitimin e treguesve gjeografikë apo emërtimet e origjinës; Mallrat apo shërbimet që nëpërmjet përdorimit lejojnë të përdoret reputacioni i treguesve gjeografikë apo emërtimet e origjinës.

Niveli i lartë i mbrojtjes që siguron marrëveshja për verërat dhe pijet alkoolike është afër standardit të marrëveshjes së Lisbonës të vitit 1958 dhe ndoshta edhe më shumë tani me aktin e Gjenevës.

Pas marrjes së një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të emërimit të origjinës ose të një treguesi gjeografik në formën e duhur, Byroja Ndërkombëtare regjistron emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik në Regjistrin Ndërkombëtar. Data e regjistrimit ndërkombëtar është data kur është marrë nga Byroja Ndërkombëtare.

Regjistrimet ndërkombëtare janë të vlefshme për një kohë të pa pacaktuar, në kuptimin që mbrojtja e një emërtimi të regjistruar të origjinës ose treguesi gjeografik nuk kërkohet më nëse emri i emërimit të origjinës ose i treguesit gjeografik nuk është më i mbrojtur në Palën Kontraktuese të Origjinës

Eduard Shalsi – Falemnderit znj. Nurçe.

Do të vazhdojmë me pyetjet, përgjigjet dhe komentet, nëse ka.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa u takon kolegëve, të cilët mund të kishin pyetje për çështje të ndryshme, kërkesat e tyre t'i depozitojnë te sekretaria e komisionit dhe në vazhden e vizitave që ne do të organizojmë nëpër institucione të ndryshme, mund t'i dërgojmë paraprakisht shqetësimet që ne kemi.

A jeni dakord, të nderuar kolegë, të vazhdojmë me votimin e projektligjit?

Pa humbur kohë po hedh projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” në votim në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Zonja Zëvendësministre, Ju uroj punë të mbarë dhe do të mbetemi në kontakt edhe për çështje të tjera.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA